



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
KOMISIONI I KONKURENCËS

**VENDIM**

**Nr. 776, Datë 04.03.2021**

**“Kërkesë për sigurimin e të dhënave nga ana e ndërmarrjes Aquarius  
Medical SHPK”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Eduard YPI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 04.03.2021, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Kërkesë për sigurimin e të dhënave nga ana e ndërmarrjes Aquarius Medical SHPK.

**Baza Ligjore:** Neni 24, germa (d), neni 33 pika 2 dhe pika 3, neni 43, dhe neni 74 pika 1, germa (a), të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji nr. 9121/2003).

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

**VËREN SE :**

- 1- Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave” vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
- 2- Me qëllim realizimin e një analize të plotë të ndërmarrjeve të cilat sipas monitorimit janë konstatuar se ushtrojnë aktivitet në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave, vlerësohet se është e nevojshme hapja e procedurës së hetimit të thelluar edhe ndaj ndërmarrjeve Capital Group SHPK, Florfarma SHPK, Euromed SHPK, Aquarius Medical SHPK, New Medical Plus SHPK, Fedos SHPK dhe Winpharma SHPK.

- 3- Për këto arsye, KK bazuar në nenin 4, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 43 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, me VKK nr. 752, datë 03.12.2020 “Për një shtesë në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave”, vendosi në pikën “1”, shtohen ndërmarrjet Capital Group SHPK, Florfarma SHPK, Euromed SHPK, Aquarius Medical SHPK, New Medical Plus SHPK, Fedos SHPK dhe Winpharma SHPK.
- 4- Autoriteti i Konkurrencës për realizimin e procedurave hetimore për vlerësimin e konkurrencës në tregun e tregtimit me shumicë të këtyre materialeve paramjekësore me shkresën nr. 110/84 prot., datë 09.12.2020 “Kërkesë për informacion”, i është drejtuar ndërmarrjes Aquarius Medical SHPK, në lidhje me shit-blerjet analitike dhe importet analitike për periudhën nga 01 nëntor 2019 deri në 31 dhjetor 2020, me afat për kthim - përgjigje brenda datës 15.01.2021. Ndërmarrja Aquarius Medical SHPK nuk i është përgjigjur kërkesës për informacion të Autoritetit të Konkurrencës.
- 5- Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr. 110/147 prot., datë 29.01.2021 “Rikujtesë” i është drejtuar përsëri ndërmarrja Aquarius Medical SHPK për mundësimin e sigurimit të të dhënave të nevojshme brenda datës 08.02.2021. Ndërmarrja Aquarius Medical SHPK nuk i është përgjigjur përsëri kërkesës për informacion të Autoritetit të Konkurrencës.
- 6- Informacioni i kërkuar nga Autoriteti i Konkurrencës është shumë i rëndësishëm për realizimin e procedurave hetimore, pasi përmban informacione të detajuara të veprimtarisë së ndërmarrjeve, për të cilat është hapur dhe procedura hetimore.
- 7- Për sa më sipër, kur ndërmarrjet nuk japin të dhënat e kërkuara, brenda periudhës së caktuar në kërkesën e Sekretariatit, në zbatim të nenit 33, pika 2 dhe pika 3 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, Komisioni kur e vlerëson të nevojshme i kërkon të dhënat nëpërmjet një vendimi.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d), nenin 33 pika 2 dhe pika 3, nenin 43 dhe nenin 74 pika 1, germa (a) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

### **VENDOSI:**

- I. T’i kërkojë ndërmarrjes Aquarius Medical SHPK të depozitojë pranë Autoritetit të Konkurrencës informacionin si më poshtë vijon:
  - a. *Blerjet (lokale) Analitike për produkt (të gjithë llojet dhe modelet e maskave, xhelit desinfektant, alkoolit dhe termometrave infrared) për periudhën 01 nëntor 2019 – 31 dhjetor 2020, duke cilësuar çmimin dhe furnitorët përkatës.*

- b. *Importet Analitike për produkt (të gjithë llojet dhe modelet e maskave, xhelit desinfektant, alkoolit dhe termometrave infrared) për periudhën 01 nëntor 2019 – 31 dhjetor 2020, duke cilësuar çmimin dhe furnitorët përkatës.*
  - c. *Shitjet Analitike për produkt (të gjithë llojet dhe modelet e maskave, xhelit desinfektant, alkoolit dhe termometrave infrared) për periudhën 01 Nëntor 2019 – 31 dhjetor 2020, duke cilësuar çmimin dhe klientët përkatës.*
- II. Informacioni i përcaktuar në pikën I, duhet të përmbushet brenda afatit 15 ditor nga dita që ky vendim i është njoftuar.
- III. Në rast të mos përmbushjes së detyrimit të përcaktuar në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrja Aquarius Medical SHPK ndëshkohet me gjobë në masën jo më shumë se deri në 1 për qind të xhiros totale të vitit paraardhës financiar për shkelje të lehtë të konkurrencës në zbatim të nenit 73, pika 1, germa (a) të ligjit nr. 9121/2003.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I KONKURENCËS**